



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep**

**Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 prill 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit lidhur me Shënimin e Selimit**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të  
Specializuar**

Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** (“Trupi Gjykses”) në bazë të neneve 19(2)-(3) dhe 21 të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullës 79 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullores), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 shkurt 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një mocion sipas rregullës 154 në lidhje me dy mbështetës dëshmitarët e parë të saj (“Mocioni sipas Rregullës 154”).<sup>1</sup>
2. Më 20 shkurt 2023, ekipet e Mbrojtjes së bashku iu përgjigjën Mocionit sipas Rregullës 154.<sup>2</sup>
3. Më 16 mars 2023, Trupi Gjykses nxori vendimin e tij për atë Mocion (“Vendimi sipas Rregullës 154”).<sup>3</sup> Në të, Trupi Gjykses konstatoi, ndër të tjera, që shënimi i një deklaratë që i akuzuari Rexhep Selimi i ka dhënë një dëshmitari të Prokurorisë (“Shënimi i Selimit”) ishte i pranueshëm si provë materiale shoqëruese e deklaratës sipas rregullës 154 të një dëshmitari të ZPS-së.<sup>4</sup>
4. Më 20 mars 2023, gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) paraqiti kundërshtime mbi përdorimin dhe peshën e dhënë Shënimit të Selimit.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> F01262, Prokurori i Specializuar, 7 shkurt 2023, konfidencial, me shtojcat 1-7, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 31 mars 2023, F01262/RED.

<sup>2</sup> F01308, Mbrojtësi i Specializuar, 20 shkurt 2023, konfidencial. Një version i redaktuar u dorëzua më 31 mars 2023, F01308/RED.

<sup>3</sup> F01380, Trupi Gjykses, 16 mars 2023, konfidencial.

<sup>4</sup> Vendimi sipas Rregullës 154, para. 50.

<sup>5</sup> Transkripti i seancës, 20 mars 2023, konfidencial, f. 2125, rreshti 18 deri tek f. 2128, rreshti 12.

5. Më 31 mars 2023, the Mbrojtja e Veselit dorëzoi parashtrime të mëtejshme në lidhje me këtë dokument ("Parashtrimet e Veselit").<sup>6</sup>
6. Më 4 prill 2023, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në të dorëzonte përgjigjen ndaj Parashtrimeve të Veselit jo më vonë se të enjten, 5 prill 2023, 16:00, dhe duke mos pranuar kundërpërgjigje.<sup>7</sup>
7. Më të njëjtën ditë, 4 prill 2023, mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") iu bashkua Parashtrimeve të Veselit ("Mocioni për Bashkim i Thaçit").<sup>8</sup>
8. Më 5 prill 2023, ZPS-ja iu përgjigj Parashtrimeve të Veselit dhe Mocionit për Bashkim të Thaçit ("Përgjigjja e ZPS-së").<sup>9</sup>

## II. PARASHTRIMET

9. Mbrojtja e Veselit, së cilës i bashkohet Mbrojtja e Thaçit,<sup>10</sup> i kërkon Trupit Gjykses që: (i) ta përdorë Shënimin e Selimit si provë të faktit se është hartuar si Shënim dhe jo si provë për vërtetësinë e përmbajtjes së tij ("Kërkesa e Parë");<sup>11</sup> dhe nëse jo, (ii) gjatë kuvendimeve të saj të marrë parasysh vlerën provuese vetvetiu të ulët dhe efektin e madh dëmtues të saj ("Kërkesa e Dytë").<sup>12</sup>
10. ZPS-ja përgjigjet se Parashtrimet e Veselit duhen hedhur poshtë si përpjekje e vonuar dhe e dukshme për rishikimin e Vendimit sipas Rregullës 154, dhe se nuk i përmbushin standardet për rishikim.<sup>13</sup> Ajo argumenton se, në bazë të Rregullores, Shënimi i Selimit është i pranueshëm, i përdorshëm kundër të gjithë të akuzuarve, dhe mund të përdoret kundër z. Veseli mbi bazën e vërtetësisë së

---

<sup>6</sup> F01414, Mbrojtësi i Specializuar, 31 mars 2023, konfidencial.

<sup>7</sup> Versioni i parë i transkriptit të seancës, 4 prill 2023, f. 2266.

<sup>8</sup> F01422, Mbrojtësi i Specializuar, 4 prill 2023, konfidencial.

<sup>9</sup> F01427, Prokurori i Specializuar, 5 prill 2023, konfidencial.

<sup>10</sup> Mocioni për Bashkim i Thaçit, para. 12.

<sup>11</sup> Parashtrimet e Veselit, para. 5, 7, 11, 25, 28.

<sup>12</sup> Parashtrimet e Veselit, para. 2-3, 25-28.

<sup>13</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 9, 11, 15.

brendisë së tij.<sup>14</sup> Ajo argumenton se Parashtrimet e Veselit, në mënyrë jobindëse, përpiqen të bëjnë dallim midis pranueshmërisë të provave dhe përdorimit të tyre dhe se sa peshë i duhet dhënë Shënimit të Selimit është aspekt që duhet diskutuar në fund të procesit gjyqësor.<sup>15</sup>

### III. DISKUTIM

11. Parashtrimet e Veselit mbështeten në nenin 21(4) të Ligjit dhe rregullat 138(1) dhe 154 të Rregullores. Asnjëra nga këto dispozita nuk parasheh mjetin juridik të kërkuar nga Mbrojtja e Veselit, së cilës i është bashkuar Mbrojtja e Thaçit.

12. Meqenëse Kërkesa e Parë kërkon garanci nga Trupi Gjyqësor për të mos përdorur Shënimin e Selimit për vërtetësinë e brendisë së tij, ajo përbën, me gjithë sugjerimin e Mbrojtjes së Veselit për të kundërtën,<sup>16</sup> një mocion për rishikimin e Vendimit sipas Rregullës 154 në të cilin u konstatua se Shënimi i Selimit ishte i pranueshëm.

13. Në këtë aspekt, Trupi Gjyqësor vëren se parashtrime në thelb të ngjashme me Parashtrimet e Veselit dhe Mocionin për Bashkim të Thaçit, megjithëse në mënyrë më të kufizuar, janë bërë tek F01308.<sup>17</sup> Për ato parashtrime, Trupi Gjyqësor e ka dhënë një vendim, duke konstatuar se Shënimi i Selimit i përmbushte kriteret për pranueshmëri sipas rregullës 138(1) dhe se, në veçanti, vlera provuese e kësaj prove materiale shoqëruese të propozuar nuk kishte më pak peshë se efekti i saj dëmtues.<sup>18</sup> Rrjedhimisht, Parashtrimet e Veselit dhe Mocioni për Bashkim të Thaçit janë një tentativë thuajse e hapur për të ngritur dhe debatuar edhe një herë juridikisht një aspekt për të cilin është marrë tashmë një vendim nga Trupi

---

<sup>14</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 13.

<sup>15</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 9-10.

<sup>16</sup> Parashtrimet e Veselit, para. 2.

<sup>17</sup> F01308, para. 21(iv).

<sup>18</sup> Vendimi sipas Rregullës 154, para. 50.

Gjykues. As Mbrojtja e Veselit, as Mbrojtja e Thaçit (së bashku, “Mbrojtja”), nuk kanë vërtetuar se janë plotësuar kriteret për rishikim sipas rregullës 79. Gjithashtu, Mbrojtja nuk ka identifikuar rregulla të tjera që ta autorizojnë të kërkojë këtë mjet juridik. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues, e hedh poshtë Kërkesën e Parë.

14. Për sa i përket Kërkesës së Dytë, Trupi Gjykues do të shqyrtojë peshën e të gjitha provave të pranuar në përfundim të gjykimit.<sup>19</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues e hedh poshtë Kërkesën e Dytë si të parakohshme.

#### IV. VENDIM

15. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykues **HEDH POSHTË** Parashtrimet e Veselit dhe Mocionin për Bashkim të Thaçit.

---

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E enjte, 6 prill 2023

Në Hagë, Holandë.

---

<sup>19</sup> Rregulla 139(2). *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 January 2015, para. 1150; ICTR, *Prosecutor v. Setako*, ICTR-04-81-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 shtator 2011, para. 31, 48, 154, 222. ICTY, *Prosecutor v. Limaj et al.*, IT-03-66-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 27 September 2007, para. 88, 153.